



Pranimi / Dorezimi Punjenj / Prudato Received / Delivery		19-02	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Hr Prot Hr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKIMSHACK	735/2021		113		



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.61/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.61/2021 të datës 05.02.2021, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë rruga "Afrim Zhitia", blloku 3, hyrja 4/18 në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.61/2021 e datës 05.02.2021 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 05.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 487/2021 të regjistruar me numër A.nr.61/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për avancim në pozitë të nivelit të sektorit dhe kompensimin e së paku një koeficienti nga viti 2002 deri në mbyllje të këtij procesi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.02.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Këshilli më datë 12.02.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesë me numër protokolli 487/2021 të regjistruar me numër A.nr.61/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për kompensimin për punë të rrezikshme të ankuesit; Akt Emërimit e datës 05.01.2015 të ankuesit; Dëshmitë e daljes në terren (foto); Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës datë 18.12.2018, 23.12.2019, 29.01.2021 për ankuesin; Plani individual i trajnimit i datës 18.12.2018; Plani dhe programi individual i punës për vitin 2019 i datës 19.12.2018; Plani individual i punës për vitin 2020 i datës 16.12.2019; Plani individual i trajnimit i datës 30.12.2019; Kartela e nëpunësit civil nga lista e pagave për ankuesin; Organogramin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe Përgjigjen në ankesë te datës 12.02.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar ne shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit e datës 05.01.2015, Kolegji ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës "Hidrolog i Lartë" në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës pran Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për avancim në pozitë të nivelit të sektorit dhe kompensimin e së paku një koeficienti nga viti 2002 deri në mbyllje të këtij procesi.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për avancim nga pozita aktuale në pozitë të nivelit të sektorit, Kolegji ka analizuar legjislacionin në fuqi dhe si rrjedhojë ka konstatuar se me dispozitat e nenit 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, janë përcaktuar në mënyrë të hollësishme procedurat e ngritjes në detyrë, mbi bazën e te cilave dispozita institucionet e administratës publike ku kanë të punësuar nëpunës civil paraprakisht duhet të bëjnë planifikimin e personelit lidhur me rekrutimin, respektivisht ngritjen në detyrë të nëpunësve civilë, dhe se është në kompetencë të vetë institucionit që në kuadër të planifikimit të personelit të bëjë edhe procedimin e konkurseve në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin e së paku një koeficienti nga viti 2002 deri në mbyllje të këtij procesi, Kolegji duke iu referuar dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenit 7 ku përcaktohet se: 1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitave në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat, ka konstatuar se ngritja e koeficientëve për nëpunësit civil, mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurave ligjore e që duhet dëshmohet se institucioni ka planifikuar mjete buxhetore të miratuara nga ministria përgjegjëse për administratë publike respektivisht ministria përgjegjëse për financa, kështu përderisa nuk ka planifikim të buxhetit apo nuk ka kërkesë



nga institucioni ku nëpunësi civil është duke e ushtruar pozitën tek institucionet gjegjëse, atëherë nuk mund të ketë ngritje të koeficientit me vendim, kështu që përderisa nuk plotësohen kushtet e tilla ligjore nëpunësi civil paguhet me pagë siç është përcaktuar në aktin e emërimit me të cilin ka themeluar marrëdhënien e tij të punës, siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, respektivisht nenin 9 paragrafin 1 ku përcaktohet se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se institucionet duhet të kenë parasysh që të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore në mënyrë që të gjithë nëpunësit civil për pozita të njëjta të paguhen me pagë të njëjtë siç parashihet me nenin 3 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.61/2021

Avdyl BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit;
- Drejtorit të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

